

SHTOJCË

NË RREGULLOREN E BRENDSHME

TË FUNKSIONIMIT TË AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR

1. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.757, datë 13.12.2024, për disa ndryshime në Vendimin Nr.276 datë 16.05.2018, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e mënyrës së organizimit të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar" bëhen ndryshime në Struktura Organizative të Zyrës Qendrore të ARRSH-së.

2. Struktura Organizative e Zyrës Qendrore të ARRSH-së në zbatim të Vendimit Nr.757, datë 13.12.2024 ndryshon / shtohen në përbërje të saj :

- ▶ **DREJTORIA E QENDRËS KOMBËTARE TË MONITORIMIT TË TRAFIKUT**
- ▶ **SEKTORI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI TUNELI KRRABA**
- ▶ **SEKTORI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI TUNELI LLOGARAJA,**
- ▶ **SEKTORI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI TUNELI SKËRIFICA,**

3. Të drejtat dhe përgjegjësitë e strukturave organike dhe përshkrimet e punës së personelit rregullohen me "Manualin e përshkrimeve të punës së stafit të ARRSH-së", të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

DREJTORIA E QENDRËS KOMBËTARE TË MONITORIMIT TË TRAFIKUT(QKMT)

Në Kapitullin III, shtohet Neni 15/1 në rregulloren e ARRSH-së

Qëllimi: Drejtoria e Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Trafikut (QKMT) do të operojë lëvizjen e trafikut në rrugët kombëtare, imazhet në kohë reale të kushteve të trafikut, duke kordinuar në të njëjtën kohë veprimet me forcat e rendit dhe ekipet e tjera të zbatimit të ligjit dhe reagimin emergjent ndaj incidenteve/aksidenteve rrugore.

FUNKSIONET

- Monitorim i situatës së përgjithshme të trafikut , kërkesave dhe nevojave në rrugë e tunele.
- Koordinon aktivitetet ditore të QKMT-së për të siguruar funksionalitetet e platformës RTMCS.



- Përgjegjëse për menaxhimin e sigurisë së përdoruesit të QMKT dhe caktimin e aktiviteteve ditore
- Marrja e vendimit për të përmirësuar Sistemet e Transportit Inteligjent (ITS),
- Siguron statistika dhe raportime për të gjitha nënsistemet përgjegjëse për operacionet e përgjithshme, për të siguruar efektivitetin dhe efikasitetin në qendrën e kontrollit.
- Kryen Verifikimin, trajtimin dhe zbatimin e incidenteve/ngjarjeve.
- Monitoron funksionimin e sistemeve ITS, koordinon veprimtarinë ekonomike për përmirësimin e tyre si dhe koordinon proceset ekonomike për veprimtarinë operacionale.
- Raporton mbi mbarëvajtjen e punës periodikisht (muajore) tek Drejtori i Përgjithshëm.
- QKMT do të pajiset me stacione pune RTMCS, të cilat do të përdoren nga role të ndryshme për të përmbushur detyrat e tyre.
- Qendra Kombëtare e Monitorimit të Trafikut do të funksionojë 24/7.
- Programi ditor zgjat tetë (8) orë me përjashtim të gjysmë ore për dorëzim.
- Do të ketë turne tre ditore me staf të plotë: 6:00 – 14:00, 14:00 – 22:00, 22:00 – 6:00.
- Do të ketë një turn (1) natë me staf të reduktuar: 22:00 – 06:00.
- Në turnin e natës, është e pranueshme që një Operator Trafiku të mbulojë më shumë se një rajon.
- QKMT bashkevepron me institucionet e tjera sipas kushteve të përshkruara në rregulloren e bashkëpunimit ndërinstitutional.

Përgjegjësitë e Drejtorit të QKMT janë:

- Administrimi i QKMT.
- Monitorimi i situatës së përgjithshme të personelit, kërkesave dhe nevojave për optimizimin e performancës së QKMT.
- Marrja e vendimit për zgjerimin e sistemeve të ITS (Sistemet e Transportit Inteligjent).
- Marrja e vendimit për të përmirësuar Sistemet e Transportit Inteligjent.
- Merr masa për funksionimin me efikasitet të Sistemit të Transportit Inteligjent.
- Bashkëvepron koordinon punën me aktorët e tjerë të jashtëm /nderinstitutional, përfshirës në procesin e incidenteve/ngjarjeve.
- Monitoron funksionimin e Sistemit të Transportit Inteligjent).
- Raporton mbi mbarëvajtjen e punës periodikisht dhe/ose sa herë i kërkohet nga eprori i varesisë.
- Raporton mbi mbarëvajtjen e punës periodikisht në lidhje me zbatimin e bashkëpunimit ndërinstitutional si dhe kërkesave të Qendres Aksesit Kombëtar (NAP), duke filluar me raporte mujore e me tej.

Drejtoria e QKMT përbëhet nga dy sektorë:

- 1-Sektori i Kontrollit dhe Monitorimit të Trafikut
- 2-Sektori për Operimin në Terren.



1. SEKTORI I KONTROLLIT DHE MONITORIMIT TË TRAFIKUT

Qëllimi: Monitorimi dhe kontrolli i situatës së përgjithshme të trafikut, kërkesave dhe nevojave në rrugë.

Detyrat funksionale të këtij sektori janë:

- Monitoron situatën e përgjithshme të trafikut, kërkesave dhe nevojave në rrugë.
- Propozon nevojat për zgjerimin e sistemeve të ITS (Sistemet e Transportit Inteligjent).
- Propozon nevojat për të përmirësuar sistemet e Transportit Inteligjent.
- Kontrollon dhe monitoron funksionimin e sistemit ITS (Sistemet e Transportit Inteligjent).
- Përgjigjet për operacionet e përgjithshme, efektivitetin dhe efikasitetin e ndërrimit të turneve që puna të funksionojë 24/7.
- Koordinon dhe raporton në lidhje me aktivitetet e bashkeveprimit nderinstitucional.

Përgjegjësitë për Përgjegjësin e Sektorit:

- Ndjek dhe Monitoron situatën e përgjithshme të trafikut dhe kërkesave dhe nevojave në rrugë (rikonstruksioni i kryqëzimeve, shtimi i vendeve të parkimit, etj.).
- Jep mendim/proponon për zgjerimin e sistemeve të ITS (Sistemet e Transportit Inteligjent).
- Jep mendim/proponon për të përmirësuar sistemet e ITS (Sistemet e Transportit Inteligjent)..
- Kontrollon dhe monitoron funksionimin e sistemit ITS (Sistemet e Transportit Inteligjent)..
- Përgjigjet për operacionet e përgjithshme të sektorit, efektivitetin dhe efikasitetin e ndërrimit të turneve që puna të funksionojë 24/7
- Koordinon dhe raporton në lidhje me aktivitetet e bashkeveprimit nderinstitucional.

Përgjegjësitë për Inspektor (Monitorimi):

- Të monitorojë situatën e përgjithshme të trafikut dhe kërkesave dhe nevojave në rrugë, (rikonstruksion planimetrie dhe levizje, shtim linjave levizjes për të shmangur bllokimet etj.).
- Të monitorojë/koordinojë aktivitetet ditore të QKMT-së për të siguruar funksionalitetet e platformës RRMS (Projekti i bazuar në mirëmbajtjen dhe sigurinë e Rrugëve).
- Të monitorojë /jep zgjidhje situatës në vend për të ruajtur fluksin e trafikut.
- Të monitorojë /kontrollon operacionet e kontrollit të qendrës së kontrollit
- Të gjenerojë të gjitha statistikën dhe raportet e trafikut.

Përgjegjësitë për Specialist (Përpunues informacioni Supervisor):

- Të përpunojë informacionin e aktiviteteve ditore të operatorëve.
- Të menaxhojë dhe monitorojë informacionet e plota të operacioneve dhe operatorëve të QKMT në baza ditore.
- Të monitorojë statusin funksional të gjitha sistemeve.
- Të përgjigjet ndaj një statusi funksional të paqëndrueshëm duke e sqaruar atë me operatorët dhe duke iu drejtuar personelit të mirëmbajtjes.
- Të përgatitë katedrën e ngjarjeve kritike të planifikuara.
- Të sigurojë statistika dhe raportime për të gjitha nënsistemet në baza ditore/javore.



- Përgjegjës për dhënien e mendimeve për marrjen e masave të kontrollit të trafikut në rastet e ngjarjeve .
- Koordinon veprimtarinë e sektorëve dhe urdhëron procesin e plotësimit të detyrave.

Përgjegjësitë për Specialistin (Operator salle) :

- Të monitorojë funksionet e caktuara të ITS(Sistemet e Transportit Inteligjent), të përgatisë ngjarje të planifikuara me ndikim në trafik dhe t'u përgjigjet incidenteve të trafikut.
- Të monitorojë nënsistemet e ITS(Sistemet e Transportit Inteligjent).
- Të monitorojë trafikun nëpërmjet funksionit të caktuar të ITS(Sistemet e Transportit Inteligjent).
- Të monitorojë dhe menaxhim të alarmeve të sistemit në funksionin e caktuar të ITS (manual dhe i automatizuar).
- Të konfirmojë dhe /ose refuzon alarmet e nënsistemit duke përdorur listën e alarmeve QKMT.
- Të verifikojë dhe trajtojë incidentet/ngjarjet.
- Të sigurojë statistika dhe raportime për nënsistemet e tij të caktuara të ITS.
- Jep mendim për të marrë dhe/ ose mos marrë masa të kontrollit të trafikut në rast incidentesh / ngjarjesh.

Përgjegjësitë për Specialistin (Dispeçeri) :

- Të Menaxhojë veprimet e caktuara të ITS, do të përgatisë ngjarje të planifikuara me ndikim në trafik dhe do t'i përgjigjet incidenteve të trafikut.
- Të dokumentojë i procesit të veprimtarisë së nënsistemeve të IST(Sistemet e Transportit Inteligjent), në situata emergjente.
- Të koordinojë trafikun nëpërmjet funksioneve dhe bashkëpunëtorëve të caktuar të ITS.
- Të dokumentojë dhe mbyllë të gjithë alarmet e caktuar nga mbikëqyrësit e ITS (manual dhe i automatizuar).
- Të konfirmojë / refuzon alarmet e nënsistemit duke përdorur listën e alarmeve QKMT.
- Të verifikojë, trajtojë dhe dokumentojë rastin e incidenteve/ngjarjeve.
- Të sigurojë statistika dhe raportime për operacionet e tij të caktuara të ITS.
- Jep mendim për të marrë dhe/ ose mos marrë masa të kontrollit të trafikut në rast incidentesh / ngjarjesh.
- Të koordinojë punën me institucionet e bashkeveprimit, përfshirë në procesin e incidenteve/ngjarjeve sipas udhëzimeve të manualit të procedurave dhe urdherave sipas hierarkisë.

Përgjegjësitë për Specialistin (Operator i thirrjeve):

- Të menaxhojë veprimet e caktuara në thirrjet e marra dhe do të ekzekutojë skriptet dhe urdhrat e përgatitura nga QKMT.
- Të dokumentojë procesin e aktivitetit të telefonatave / thirrjeve .
- Të koordinojë rrjedhën e thirrjeve sipas funksioneve dhe bashkëpunëtorëve të caktuar.
- Të dokumentojë dhe mbylljen e të gjithë alarmeve të caktuara nga sistemi (manual dhe i automatizuar).



- Të kryejë verifikimin e incidenteve me dispeçerët dhe operatorët e ITS. (Sistemet e Transportit Inteligjent).
- Të sigurojë/raportoje periodikisht statistika në baza ndërrime të turneve të punës.

2. SEKTORI PËR OPERIMIN NË TERREN.

Qëllimi: Evidentimi, monitorimi, konfirmimi dhe operimi i sinjalizimeve në rajonin e tij të interesit, si dhe evidenton e koordinon mirëmbajtjen parashikuese, parandaluese dhe korrigjuese të gjitha pajisjeve të kërkuara hardwer në tërësi të Platformes QKMT.

Detyrat funksionale të këtij sektori janë:

- Monitorimi dhe konfirmimi i sinjalizimeve në rajonin e tij të interesit;
- Koordinojnë dhe evidentojnë mirëmbajtjen parashikuese, parandaluese dhe korrigjuese të të gjitha pajisjeve të nënsistemit të platformës QKMT të instaluar në rajone.
- Evidentimin e ngjarjeve dhe sistemeve jofunksionale, dokumentimin e tyre dhe veprimet ndihmëse.
- Aktivizimin e njësive të lëvizshme dhe koordinimin e veprimeve në terren;

Përgjegjësitë për Përgjegjësin e Sektorit:

- Përgjegjës për monitorimin dhe konfirmimin e sinjalizimeve në rajonin e tij të interesit
- Përgjegjës për evidentimin e ngjarjeve dhe sistemeve jofunksionale, dokumentimin e tyre dhe veprimet ndihmëse.
- Përgjegjës për mirëmbajtjen parashikuese, parandaluese dhe korrigjuese të të gjitha pajisjeve të nënsistemit të platformës QKMT të instaluar në rajone.
- Përgjegjës për aktivizimin e njësive të lëvizshme.
- Koordinon me institucionet homologe gjatë procesit të operimit.

Përgjegjësitë për Specialistët (Operatorët e terrenit):

- Të kryejë monitorimin dhe konfirmimin e sinjalizimeve në rajonin/stacionin e tij të punës.
- Të kryejë evidentimin e ngjarjeve dhe sistemeve jofunksionale, dokumentimin e tyre dhe veprimet ndihmëse.
- Të kryejë mirëmbajtjen parashikuese, parandaluese dhe korrigjuese të të gjitha pajisjeve të nënsistemit të platformës QKMT të instaluar në rajone.
- Të zgjidhë problematikat që mund të dalin në pajisjet në QKMT.
- Raporton tek përgjegjësi i sektorit periodikisht sipas të turneve të punës.
- Konfirmon lokalizimin e problemit.
- Të sigurojë riparimin e zëvendësimin e kontrollorëve, sinjaleve, instalimeve elektrike, detektorëve dhe pajisjeve të tjera.
- Koordinon me institucionet homologe gjatë procesit të operimit



I gjithë personeli i Qendrës së Kontrollit dhe Monitorimit Rrugor duhet të zbatojë me përpikëri rregulloret dhe Proçedurat Standarde të Operimit (SOP) të aprovuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

DREJTORIA E NDËRTIMIT DHE MIRËMBAJTJES (DNM)

Shtohen në Kapitullin III, Neni 10 të Rregullores së ARRSH-së

ORGANIZIMI

Në përbërje të Drejtorisë së DNM-së shtohen tre(3) Sektorë:

- 6. SEKTORI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI TUNELI KRRABA**
- 7. SEKTORI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI TUNELI LLOGARAJA**
- 8. SEKTORI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI TUNELI SKËRFICA**

Misioni dhe veprimtaria e Sektorit të MZSH-së.

- Ligji Nr. 152/2015 “ Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” përcakton Misionin e shërbimit të MZSH-së, : - Misioni i këtij shërbimi është inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut ”.

Përkufizimet / Termat që lidhen me stacionin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit , në këtë ligj kanë kuptimet si më poshtë vijojnë :

- **“Akti i ekspertimit të zjarrit”** është akti administrativ, i përpiluar për çdo zjarr të rënë dhe i lëshuar nga shërbimi i MZSH-së, me kërkesë të institucioneve të prokurorisë dhe gjykatës, të shtetasve, personave fizikë e juridikë.
- **“Certifikatë e mbrojtjes nga zjarri”** është akti administrativ, i lëshuar nga shërbimi i MZSH-së, nëpërmjet të cilit provohet përmbyllja e kërkesave të parashikuara në projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas kategorizimit të objekteve.
- **“Evakuim”** është lëvizja e organizuar e personave në një vend më të sigurt, në rast të një zjarri apo rreziqeve e fatkeqësive të tjera.
- **“Fatkeqësi natyrore”** janë tërmetet, përmbytjet, thatësitrat atmosferike të tejzgjatura, rrëshqitjet tektonike, ortelet, erërat e forta, zjarret masive në pyje, të cilat rrezikojnë jetën e njeriut, gjësë së gjallë dhe pronën, si dhe ngjarje të tjera të shkaktuara nga dukuri natyrore, të cilat kërkojnë ndërhyrjen e shërbimit zjarrfikës dhe të forcave të tjera operuese.
- **“Hidrantë zjarrfikës”** janë pjesë të sistemit hidrik, të cilat shërbejnë për marrjen e ujit nga tubacionet e rrjetit ujësjellës apo burime të tjera uji për shuarjen e zjarrit.



- **“Inspektim për mbrojtjen nga zjarri”** është kontrolli që kryhet nga strukturat e shërbimit të MZSH-së për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, për mbrojtjen nga zjarri.
- **“Inspektor për mbrojtjen nga zjarri”** është punonjësi i strukturave të shërbimit të MZSH-së, i autorizuar për inspektimin e masave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.
- **“Masat parandaluese të rënies së zjarrit”** është tërësia e masave të marra për zbatimin e normave dhe standardeve, që nga projektimi i objektit, ndërtimi, kompletimi, instruktimi, përdorimi dhe mirëmbajtja e masave dhe mjeteve të sinjalizimit dhe shuarjes së zjarrit.
- **“Ndërhyrje operuese zjarrfikëse”** është puna e përditshme e shërbimit zjarrfikës, për realizimin dhe kryerjen e misionit të saj, të gjitha ndërhyrjet e menjëhershme të strukturave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, vetëm apo në bashkëpunim me shërbimet të tjera, Policinë e Shtetit, shërbimin e urgjencës mjekësore, Forcat e Armatosura etj., për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës së njeriut dhe pronës në raste zjarri, aksidentesh, incidentesh dhe emergjencash të ndryshme.
- **“Organizim i ndërhyrjes në shuarjen e zjarrit dhe shpëtim”** është tërësia e masave tekniko-organizative të nevojshme, për organizimin e forcave të ndryshme, mjeteve, pajisjeve zjarrfikëse, metodave e taktikave, të cilat përdoren për ndërhyrjen në shuarjen e zjarrit, evakuimin dhe shpëtimin e jetës së njerëzve, kafshëve dhe pronës.
- **“Pajisje të tjera zjarrfikëse dhe të shpëtimit”** janë të gjitha ato pajisje që shërbejnë për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimin e jetës, pronës e mjedisit nga rreziku i zjarrit dhe fatkeqësive të tjera natyrore.
- **“Stacion zjarrfikës”** është pjesë e infrastrukturës operuese të shërbimit të MZSH-së, që vepron në një territor të caktuar, kompletuar me personel zjarrfikës, automjete dhe pajisje zjarrfikëse, për ndërhyrjen në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin.
- **“Zjarrfikës”** është personi i emëruar në strukturat e shërbimit të MZSH-së, i trajnuar profesionalisht për të ndërhyrë në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës së njeriut, të gjësë së gjallë dhe të pronës.
- **“Rregulla të brendshme”**, tërësia e rregullave dhe e normave, në bazë të të cilave organizohet puna dhe aktiviteti i strukturave të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi.
- **“Drejtoria/Spektori i Shërbimit të MZSH-së”**, në nivel vendor, është struktura administrative/operuese e organizimit të shërbimit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, e cila është përgjegjëse për detyrat që i caktohen shprehimisht në ligj dhe akte të tjera brenda fushës së përgjegjësisë, në varësi të kryetarit të bashkisë /te Drejtorit te Përgjithshem te ARRSH-se.
- **“Spektori i ndërhyrjes”**, struktura operuese në nivel vendor, përgjegjëse për ndërhyrjet operacionale, për fikjen e zjarreve, shpëtimin e jetës, të gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve e kullotave, në aksidente të ndryshme dhe fatkeqësi natyrore.
- **“Spektori i parandalimit”**, struktura administrative në nivel vendor, përgjegjëse për inspektimin e parandalimit e aksidenteve nga zjarri.
- **“Spektori i mbështetjes”**, struktura administrative, përgjegjëse për aktivët e strukturës së shërbimit të MZSH-së dhe për menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi e keqpërdorimi.
- **“Stacioni i MZSH-së”**, pjesa kryesore e infrastrukturës operuese të shërbimit të MZSH-së, i organizuar me personel zjarrfikës të gatishmërisë së përhershme, që veprojnë në



territorin e objektit strategjik dhe është i përbërë nga 4 (katër) trupa shërbimi, të cilët kanë në dispozicion automjete dhe pajisje speciale për ndërhyrjen në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës e të pronës.

- **“Punonjës me detyra drejtuese”**, punonjësit e nivelit të mesëm e të lartë, në strukturat e shërbimit të MZSH-së, që drejtojnë strukturat e shërbimit të MZSH-së, në nivel qendror e vendor, sipas hierarkisë organike të strukturës.
- **“Punonjës me detyra inspektuese”**, punonjësit e nivelit të lartë, në drejtorinë qendrore, dhe të mesëm, në strukturat vendore të shërbimit të MZSH-së.
- **“Punonjës i nivelit bazë”**, punonjësi i shërbimit të MZSH-së që kryen detyrat e ndërhyrjes operacionale.
- **“Veprime operuese”**, ndërhyrje teknike të karakterizuara nga kërkesa e menjëhershme e performancës, për të cilën kërkohet profesionalizëm teknik, madje me përmbajtje të lartë të specializuar dhe burime të përshtatshme instrumentale.
- **“Pezullim disiplinor”**, ndërprerje e përkohshme e ushtrimit të funksionit dhe e detyrave në shërbimin e MZSH-së.

VEPRIMTARIA DHE ORGANIZIMI I STRUKTURËS SË SHËRBIMIT MZSH-së.

Veprimtaria dhe organizimi i strukturës së MZSH-së mbështetet në **Ligjin 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”**, si dhe **VKM-në Nr.520, datë 25.07.2019, “Për miratimin e Rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”**, ku ndër të tjera përcaktohet se:

- Punonjësit e stacioneve të shërbimit të MZSH-së në objektet me rëndësi ekonomike e strategjike emërohen nga subjekti që i ka ato në pronësi apo administrim, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë ligj.
- Stacioni zjarrfikës është pjesë e infrastrukturës operuese dhe inspektuese të Shërbimit të MZSH-së, që vepron në një territor të caktuar, kompletuar me personel zjarrfikës, automjete dhe pajisje zjarrfikëse, për ndërhyrjen në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin, si dhe në rast aksidenti apo fatkeqësie.
- Çdo grup i gatshëm i punonjësve të Shërbimit të MZSH-së, në stacionin zjarrfikës në nivel vendor, me marrjen e sinjalit të alarmit, ka si kohë reagimi 40 (dyzet) sekonda, gjatë kohës ditore, dhe 1 (një) minutë, gjatë natës, të dalë nga stacioni e të adresohet drejt vendit të ngjarjes.
- Stacioni i MZSH-së, në parim, ndërtohet/stacionohet sa më pranë territorit/**objektet me rëndësi ekonomike e strategjike**, në pozicion të tillë që të mbërrijë në objekt për jo më shumë se 8 (tetë) minuta dhe të ofrojë shërbimin e njësisë vendore, jo më vonë se 30 (tridhjetë) minuta, por duke konsideruar edhe largësinë e vendngjarjes nga stacioni.
- Drejtues i drejtpërdrejtë i stacionit zjarrfikës është shefi i sektorit/kryeinspektori ose, në mungesë të tij, personi i deleguar nga eprori i drejtorise se varesise.



6. SEKTORI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI TUNELI KRRABA

Qëllimi: Bazuar ne ligjin Nr. 152/2015 “ Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” Misioni i shërbimit të MZSH-së, është inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave ne aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore si dhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

Stacioni zjarrfikës është pjesë e infrastrukturës operuese të shërbimit të MZSH-së që vepron në një territor të caktuar, kompletuar me personel zjarrfikës, automjete dhe pajisje zjarrfikëse për ndërhyrjen në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin.

Detyrat funksionale të këtij sektori janë:

Shërbimi i MZSH-së tuneli i Krrabës ka këto detyra kryesore:

- Ndërhyn me të gjitha mjetet dhe forcat që disponon për shuarjen e zjarreve, shpëtimin e jetës së njeriut, gjësë së gjallë e pronës, për çdo rast, aksident, incident, fatkeqësi dhe emergjenca të ndryshme ne territorin qe mbulon , Tuneli i Krrabës;
- Harton raportin e ndërhyrjes, me forcat, mjetet, taktikën e përdorur, kostot e ndërhyrjes, dëmin e përafërt të shkaktuar nga zjarri;
- Organizon, inspekton dhe jep asistencë teknike për zbatimin e ligjshmërisë, të normave e të rregullave për sigurinë e jetës së njerëzve, të pronës, nga rreziku i zjarrit;
- Organizon punën për rritjen e gatishmërinë së mjeteve, pajisjeve e personelit për rritjen e efikasitetit në ndërhyrjen në kohë për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin, në raste fatkeqësish të ndryshme;’
- Organizon stërvitje demonstrative, takime e trajnime me institucione dhe subjekte të ndryshme, për dhënien e njohurive mbi sigurinë nga zjarri;
- Ndihmon organet e hetimit, me kërkesën e tyre, për hetimin dhe sqarimin e rrethanave e të shkaqeve të rënies së zjarrit dhe bën aktin e ekspertizës teknike;
- Bashkëpunon dhe koordinon me strukturat e Policisë së Shtetit, me institucione të sigurisë publike, strukturat e Forcave të Armatosura, shërbimin e Mbrojtjes Civile, shërbimin e urgjencës mjekësore, për shpëtimin e jetës së njerëzve e të pronës nga zjarri, rreziqet teknologjike, fatkeqësitë natyrore e fatkeqësi të tjera;
- Përpilon evidenca statistikore për çdo rast ndërhyrjeje e inspektimi dhe i dërgon në Drejtorinë e DNM-se dhe /ose Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së;



- Kryen studime në fushën e sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin, në bashkëpunim me institucionet studimore, shkencore e projektuese;
- Njofton, rregullisht, publikun për detyrat dhe masat në fushën e sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin, për rreziqet që vijnë në rast zjarresh, fatkeqësish natyrore, teknologjike, si dhe për mënyrën e dhënies së ndihmës në këto raste, përmes formave të ndryshme të informimit

Përgjegjësitë për Përgjegjësin e Sektorit/ Kryeinspektori :

- Përgjigjet për detyrat operuese të shërbimit të MZSH-së
- Përgjigjet për gatishmërinë e efektivit, planëzimin e shërbimit 12 ose 24-orësh, plotësimin e librit të shërbimit,
- Përgjigjet për gatishmërinë e mjeteve e të pajisjeve, për zhvillimin e programit të stërvitjes, për rritjen e aftësive profesionale të punonjësve të stacionit;
- Përgjigjet për hartimin e raportit të ndërhyrjes lidhur me forcat, mjetet, taktikën e përdorur, kostot e ndërhyrjes, dëmin e përafërt të shkaktuar nga zjarri dhe mban statistika për zjarret e rëna/ndërhyrjet;
- Përgjigjet për koordinimin e mirembajtjen e statistikave të ndërhyrjeve, hartën e sistemit hidrik, numrin e hidrantëve, vendndodhjen e tyre dhe burimet e tjera alternative të furnizimit me ujë në territor;
- Përgjigjet për zhvillimin, çdo muaj, të kalendarit të stërvitjeve fizike dhe demonstrative, sipas planeve vjetore të miratuara nga drejtori i drejtorisë/MZSH-së në në territorin e objektit të caktuar.

7. SEKTORI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI TUNELI LLOGARAJA

Qëllimi: Bazuar në ligjin Nr. 152/2015 “ Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” Misioni i shërbimit të MZSH-së, është inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjëse së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqsi natyrore si dhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

Stacioni zjarrfikës është pjesë e infrastrukturës operuese të shërbimit të MZSH-së që vepron në një territor të caktuar, kompletuar me personel zjarrfikës, automjete dhe pajisje zjarrfikëse për ndërhyrjen në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin.

Detyrat funksionale të këtij sektori janë:

Shërbimi i MZSH-së tuneli Llogarasë ka këto detyra kryesore:

- Ndërhyn me të gjitha mjetet dhe forcat që disponon për shuarjen e zjarreve, shpëtimin e



jetës së njeriut, gjësë së gjallë e pronës, për çdo rast, aksident, incident, fatkeqësi dhe emergjenca të ndryshme në territorin që mbulon, Tuneli i Llogarasë;

- Harton raportin e ndërhyrjes, me forcat, mjetet, taktikën e përdorur, kostot e ndërhyrjes, dëmin e përafërt të shkaktuar nga zjarri;
- Organizon, inspekton dhe jep asistencë teknike për zbatimin e ligjshmërisë, të normave e të rregullave për sigurinë e jetës së njerëzve, të pronës, nga rreziku i zjarrit;
- Organizon punën për rritjen e gatishmërinë së mjeteve, pajisjeve e personelit për rritjen e efikasitetit në ndërhyrjen në kohë për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin, në raste fatkeqësish të ndryshme;
- Organizon stërvitje demonstrative, takime e trajnime me institucione dhe subjekte të ndryshme, për dhënien e njohurive mbi sigurinë nga zjarri;
- Ndihmon organet e hetimit, me kërkesën e tyre, për hetimin dhe sqarimin e rrethanave e të shkaqeve të rënies së zjarrit dhe bën aktin e ekspertizës teknike;
- Bashkëpunon dhe koordinon me strukturat e Policisë së Shtetit, me institucione të sigurisë publike, strukturat e Forcave të Armatosura, shërbimin e Mbrojtjes Civile, shërbimin e urgjencës mjekësore, për shpëtimin e jetës së njerëzve e të pronës nga zjarri, rreziqet teknologjike, fatkeqësitë natyrore e fatkeqësi të tjera;
- Përpilon evidenca statistikore për çdo rast ndërhyrjeje e inspektimi dhe i dërgon në Drejtorinë e DNM-se dhe /ose Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së;
- Kryen studime në fushën e sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin, në bashkëpunim me institucionet studimore, shkencore e projektuese;
- Njofton, rregullisht, publikun për detyrat dhe masat në fushën e sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin, për rreziqet që vijnë në rast zjarresh, fatkeqësish natyrore, teknologjike, si dhe për mënyrën e dhënies së ndihmës në këto raste, përmes formave të ndryshme të informimit

Përgjegjësitë për Përgjegjësin e Sektorit/ Kryeinspektori :

- Përgjigjet për detyrat operuese të shërbimit të MZSH-së
- Përgjigjet për gatishmërinë e efektivit, planëzimin e shërbimit 12 ose 24-orësh, plotësimin e librit të shërbimit,
- Përgjigjet për gatishmërinë e mjeteve e të pajisjeve, për zhvillimin e programit të stërvitjes, për rritjen e aftësive profesionale të punonjësve të stacionit;
- Përgjigjet për hartimin e raportit të ndërhyrjes lidhur me forcat, mjetet, taktikën e përdorur, kostot e ndërhyrjes, dëmin e përafërt të shkaktuar nga zjarri dhe mban statistika për zjarret e rëna/ndërhyrjet;



- Përgjigjet për mbajtjen e statistikave të ndërhyrjeve, hartën e sistemit hidrik, numrin e hidrantëve, vendndodhjen e tyre dhe burimet e tjera alternative të furnizimit me ujë në territor;
- Përgjigjet për zhvillimin, çdo muaj, të kalendarit të stërvitjeve fizike dhe demonstrative, sipas planeve vjetore të miratuara nga drejtori i drejtorisë/MZSH-së në territorin e objektit të caktuar.

8. SEKTORI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI TUNELI SKËRFICA

Qëllimi: Bazuar në ligjin Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” Misioni i shërbimit të MZSH-së, është inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqsi natyrore si dhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

Stacioni zjarrfikës është pjesë e infrastrukturës operuese të shërbimit të MZSH-së që vepron në një territor të caktuar, kompletuar me personel zjarrfikës, automjete dhe pajisje zjarrfikëse për ndërhyrjen në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin.

Detyrat funksionale të këtij sektori janë:

Shërbimi i MZSH-së tuneli Skërficës ka këto detyra kryesore:

- Ndërhyn me të gjitha mjetet dhe forcat që disponon për shuarjen e zjarreve, shpëtimin e jetës së njeriut, gjësë së gjallë e pronës, për çdo rast, aksident, incident, fatkeqësi dhe emergjenca të ndryshme në territorin që mbulon, Tuneli i Skërficës;
- Harton raportin e ndërhyrjes, me forcat, mjetet, taktikën e përdorur, kostot e ndërhyrjes, dëmin e përafërt të shkaktuar nga zjarri;
- Organizon, inspekton dhe jep asistencë teknike për zbatimin e ligjshmërisë, të normave e të rregullave për sigurinë e jetës së njerëzve, të pronës, nga rreziku i zjarrit;
- Organizon punën për rritjen e gatishmërinë së mjeteve, pajisjeve e personelit për rritjen e efikasitetit në ndërhyrjen në kohë për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin, në raste fatkeqësish të ndryshme;
- Organizon stërvitje demonstrative, takime e trajnime me institucione dhe subjekte të ndryshme, për dhënien e njohurive mbi sigurinë nga zjarri;
- Ndihmon organet e hetimit, me kërkesën e tyre, për hetimin dhe sqarimin e rrethanave e të shkaqeve të rënies së zjarrit dhe bën aktin e ekspertizës teknike;
- Bashkëpunon dhe koordinon me strukturat e Policisë së Shtetit, me institucione të



sigurisë publike, strukturat e Forcave të Armatosura, shërbimin e Mbrojtjes Civile, shërbimin e urgjencës mjekësore, për shpëtimin e jetës së njerëzve e të pronës nga zjarri, rreziqet teknologjike, fatkeqësitë natyrore e fatkeqësi të tjera;

- Përpilon evidenca statistikore për çdo rast ndërhyrjeje e inspektimi dhe i dërgon në Drejtorinë e DNM-së dhe /ose Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së;
- Kryen studime në fushën e sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin, në bashkëpunim me institucionet studimore, shkencore e projektuese;
- Njofton, rregullisht, publikun për detyrat dhe masat në fushën e sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin, për rreziqet që vijnë në rast zjarresh, fatkeqësish natyrore, teknologjike, si dhe për mënyrën e dhënies së ndihmës në këto raste, përmes formave të ndryshme të informimit

Përgjegjësitë për Përgjegjësin e Sektorit/ Kryeinspektori :

- Përgjigjet për detyrat operuese të shërbimit të MZSH-së
- Përgjigjet për gatishmërinë e efektivit, planëzimin e shërbimit 12 ose 24-orësh, plotësimin e librit të shërbimit,
- Përgjigjet për gatishmërinë e mjeteve e të pajisjeve, për zhvillimin e programit të stërvitjes, për rritjen e aftësive profesionale të punonjësve të stacionit;
- Përgjigjet për hartimin e raportit të ndërhyrjes lidhur me forcat, mjetet, taktikën e përdorur, kostot e ndërhyrjes, dëmin e përafërt të shkaktuar nga zjarri dhe mban statistika për zjarret e rëna/ndërhyrjet;
- Përgjigjet për mbajtjen e statistikave të ndërhyrjeve, hartën e sistemit hidrik, numrin e hidrantëve, vendndodhjen e tyre dhe burimet e tjera alternative të furnizimit me ujë në territor;
- Përgjigjet për zhvillimin, çdo muaj, të kalendarit të stërvitjeve fizike dhe demonstrative, sipas planeve vjetore të miratuara nga drejtori i drejtorisë/MZSH-së në territorin e objektit të caktuar.

I gjithë personeli i MZSH-së duhet të zbatojë me përpikmëri rregulloret dhe Proçedurat Standarde të Operimit të aprovuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.



SHTOJCË

NË RREGULLOREN E BRENDSHME

TË FUNKSIONIMIT TË AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR

1. Në zbatim të Ligjit Nr.10164 datë 15/10/2009,"Për Autoritetin Rrugor Shqiptar",Rregullores së Brendshme Nr.7493/2, datë 04/09/2018, miratuar me Vendim Bordi Nr.10, datë 04/09/2018, të ndryshuar, të ligjit 114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik", të ndryshuar,Manualit të Auditimit të Brendshëm " Vlerësimi i jashtëm i cilësisë", të ndryshuar dhe Metodologjisë së " Vlerësimit të jashtëm të cilësisë"

2. Në Rregulloren e Brendshme të ARRSH-së në zbatim të Vendimit Nr.219,datë 01/10/2025 shtohen në përbërje të saj :

► TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E AUDITUESVE TË BRENDSHËM

3. Të drejtat dhe përgjegjësitë e strukturave organike dhe përshkrimet e punës së personelit rregullohen me "Manualin e përshkrimeve të punës së stafit të ARRSH-së", të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

► TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E AUDITUESVE TË BRENDSHËM

Në nenin 14 SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM, shtohen "Të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Audituesve të Brendshëm" në rregulloren e ARRSH-së

Përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm.

Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm është përgjegjës për:

- a) organizimin e angazhimeve të auditimit të brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me nenin 8 të këtij ligji;
- b) hartimin e Kartës së Auditimit, dhe dërgimi për informacion në DHAB;
- c) hartimin dhe zbatimin e planit strategjik e vjetor për veprimtarinë e auditimit të brendshëm dhe dërgimin për informacion në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, pas miratimit nga titullari i njësisë publike;
- ç) përgatitjen e raportit vjetor, i cili i dërgohet strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm dhe përmban të dhënat e mëposhtme, por nuk kufizohet vetëm në to:
 - angazhimet e auditimit, të kryer gjatë periudhës së raportuar;
 - shmangiet nga plani, arsyet dhe argumentet përkatëse;

- vlerësimin e sistemeve të kontrollit brenda njësisë publike dhe për rekomandimet për përmirësim;
- veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar;

d) raportimin menjëherë në formë të shkruar tek titullari i njësisë publike dhe te Ministri i Financave, i cili ka në varësi strukturën e inspektimit financiar publik, kur zbulon parregullsi apo veprime, që në vlerësimin e njësisë së auditimit përbëjnë vepër penale.

Përgjegjësitë e audituesve të brendshëm.

Përgjegjësitë e audituesve të brendshëm janë:

a) të njohin, të respektojnë dhe të ushtrojnë veprimtarinë audituese në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe me standardet ndërkombëtare, të pranuara, të auditimit të brendshëm;

b) të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë objektive dhe me profesionalizëm;

c) të veprojnë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kodin e Etikës, Kartën e Auditimit dhe rregullat për konfidencialitetin për audituesin e brendshëm;

ç) të kryejnë auditime në mënyrë të pavarur, duke u udhëhequr nga interesi publik, për të forcuar besimin në ndershmërinë, paanësinë dhe efektivitetin e shërbimit;

d) të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave, fakteve apo rasteve të gjetura gjatë kryerjes së auditimit apo të lidhur me të, si dhe të ruajnë dokumentet për çdo angazhim auditimi të kryer, bazuar në detyrimet, që rrjedhin nga ligjet në fuqi për të drejtat e përdorimit dhe të arkivimit të informacionit zyrtar;

dh) të përditësojnë rregullisht njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që t'i përdorin ato me efikasitet dhe për të garantuar cilësinë e shërbimit;

e) të japin rekomandime për njësinë e audituar për përmirësimin e veprimtarisë, efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe për masat që duhen ndërmarrë në rastet e konstatimit të dëmeve ekonomike e financiare për zhdëmtimin e tyre dhe për të ulur mundësinë e përsëritjes;

ë) të raportojnë menjëherë te drejtuesi i njësisë së auditimit kur zbulohen parregullsi apo veprime, që në vlerësimin e audituesve të brendshëm përbëjnë vepër penale.

Të drejtat e audituesve të brendshëm.

Audituesit e brendshëm, në kryerjen e misionit të tyre, kanë të drejtat e mëposhtme:

a) të ushtrojnë në mënyrë të pavarur funksionin e auditimit, pa lënë hapësirë për ndërhyrje nga kolegët, mbikëqyrësit, drejtuesit e njësisë së auditimit apo pala e audituar, me përjashtim të marrëdhënieve të ndërsjella të këshillimit;

b) të kërkojnë dhe të sigurojnë të gjitha të dhënat me karakter teknik, ekonomik e financiar dhe menaxherial të njësisë që auditohet, duke marrë përsipër ruajtjen e fshehtësisë së tyre, sipas legjislacionit në fuqi;

c) të marrin nga punonjësit e njësisë së audituar, për rastet që gjykohet e nevojshme, shpjegime, deklaratat dhe fotokopje të dokumenteve, në të cilat titullari i njësisë publike të audituar ka vënë

shënimin “e njëjtë me origjinalin”, si dhe materiale të transportueshme, në formë elektronike, që janë subjekt i auditimit të brendshëm;

ç) të kenë kushtet e nevojshme, zyrë dhe pajisje logjistike të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë së auditimit, kur auditimi kryhet jashtë ambienteve të njësisë publike;

d) të ndjekin, në mënyrë periodike, trajnimin e vijueshëm profesional, sipas kërkesave të nenit 20 të këtij ligji;

dh) t’i paraqesin kërkesën drejtuesit të njësisë së auditimit për heqjen dorë nga një veprimtari auditimi, kur vlerësojnë se për shkaqe të argumentuara cënohen besueshmëria dhe cilësia e auditimit ose në rastet kur veprimtaria audituese është në kushtet e konfliktit të interesit.